

URDHËR
Nr. 152, datë 15.4.2024

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES
SË ZHVILLIMIT MIDIS MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT DHE
SUBJEKTIT “KLAIS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Zhvillimit, midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektit “KLAIS” sh.p.k., në zbatim të vendimit nr. 131, datë 6.3.2024, “Për dhënien e statusit të veçantë ‘Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special’ aplikuesit ‘KLAIS’ sh.p.k.”.
2. Ngarkohet znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi